


MINISTRIA E DREJTËSISË
KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues: Kryeministria

Nr. prot.:

Data: . 04. 2023

Shkurtimi i lëndës: Dërgohet urdhri nr.50 datë 05.04.2023.

Për trajtim nga:	<i>z. Simo</i>	<i>07.04.2023.</i>
(Struktura të tjera të ngarkuara)		
Me porosi:		

MINISTRI

ZV.MINISTRI

KABINETI I MINISTRIT

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Afati: Normal (7 ditë)

Prioritet (3 ditë)

Urgjent (brenda ditës)

Pa afat/për dijeni

Tjetër: ___ ditë

Data: 06. 04. 2023

Nr. prot.: 2260

Nënshkrimi (TITULLARI)

Marrë në dorëzim: *11/04/2023*

Nënshkrimi

Kalon për trajtim (struktura): *zj. Hoxha.*

11.04.2023

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: *24. Keje*

Nënshkrimi

Kalon për trajtim (struktura): *[Signature]*

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____. 2023

Specialisti

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____. 2023

Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____. 2023


Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____. 2023

Eprori në shkallë hierarkike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI



URDHËR

Nr. 50, datë 5.4.2023

PËR

NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR HARTIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT 2024-2030, TË PLANIT TË VEPRIMIT DHE TË PASAPORTËS SË TREGUESVE

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.01.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 24, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, të planit të veprimit dhe të pasaportës së treguesve.
2. Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit të hartimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030 dhe dokumenteve të saj strategjik, me qëllim përmbushjen e detyrimit institucional për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimit dhe të përafrimit të legjislacionit të brendshëm me *acquis* dhe standardet e Bashkimit Evropian, pjesë e kapitullit 23 të *acquis*, si dhe forcimit të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet të gjitha institucioneve që veprojnë në fushën e të drejtave të viktimave të krimit.
3. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga zëvendësministri i Drejtësisë, përgjegjës për politikën dhe strategjitë në fushën e drejtësisë, dhe të ketë në përbërje përfaqësues, në nivel drejtues, nga:
 - a) Ministria e Drejtësisë;
 - b) Ministria e Brendshme;

- c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- ç) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- d) Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- dh) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
- e) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- ë) Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;
- f) Akademia e Sigurisë;
- g) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- gj) Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë;
- h) Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit;
- i) Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
- j) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- k) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës;
- l) Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas;
- ll) Komiteti Shqiptar i Birësimeve;
- m) Instituti i Mjekësisë Ligjore;
- n) Qendra e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve;
- nj) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- o) Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
- p) Shërbimi Social Shtetëror;
- q) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- r) Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

4. Pjesë e grupit ndërinstitucional të punës, nëse çmohet e nevojshme, mund të jenë edhe struktura varësie të institucioneve qendrore, të cilat kanë në fushën e tyre të përgjegjësisë çështje të lidhura me mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimit.

5. Në varësi të çështjeve të planifikuara për shqyrtim në mbledhjet e grupit ndërinstitucional të punës, ftohen të marrin pjesë, në përputhje me përgjegjësitë e tyre funksionale, përfaqësues nga:

- a) Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;
- b) Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- c) Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- ç) Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- d) Shkolla e Magjistraturës;
- dh) Prokuroria e Përgjithshme;
- e) Struktura e Posacme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit;
- ë) Avokati i Popullit;
- f) Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;

- g) Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
 - gj) Autoriteti i Medias Audiovizive;
 - h) Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë;
 - i) Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve;
 - j) Urdhri i Psikologut;
 - k) Urdhri i Punonjësit Social;
 - l) Njësitë për Mbrojtjen e Viktimave që ushtrojnë veprimtarinë pranë njësisive të vetëqeverisjes vendore;
 - ll) Koordinatorët vendorë për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare;
 - m) Organizatat e shoqërisë civile, veprimtaria e të cilave lidhet me mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave ose që përfaqësojnë viktimat.
6. Grupi ndërinstytucional i punës thirret nga kryetari, jo më pak se 2 (dy) herë në muaj. Kryetari vendos për datën dhe kohën e mbledhjeve të radhës, pas konsultimit me anëtarët e grupit ndërinstytucional të punës. Mbledhjet organizohen pranë ambienteve të Ministrisë së Drejtësisë.
7. Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit ndërinstytucional të punës janë, si më poshtë vijon:
- a) Hartimi i përmbajtjes së Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, duke përfshirë hartimin e planit të veprimit dhe pasaportës së treguesve, e cila realizohet në përputhje me:
 - i. udhëzimet e dhëna nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;
 - ii. parashikimet e vendimit nr.290, datë 11.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)”;
 - iii. qëllimet, objektivat dhe parashikimet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 – 2030;
 - iv. Strategjinë e BE-së për të drejtat e viktimave 2020-2025;
 - v. Jurisprudencën e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ);
 - vi. Konventat e Këshillit të Evropës;
 - vii. Aktet lidhur me *acquis* e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e viktimave të krimit.
 - b) Reflektimi i vendimeve të marra, vlerësimi i rekomandimeve, komenteve të dhëna nga institucionet, profesionistë, partnerë vendas dhe ndërkombëtar, me qëllim përmirësimin e cilësisë së përmbajtjes së


strategjisë dhe hartimin e planit të veprimit dhe të pasaportës së treguesve.

8. Në mbledhjet e grupit ndërinstytucional të punës, kur vlerësohet e nevojshme nga anëtarët e tij, marrin pjesë edhe përfaqësues të organizatave, të partnerëve vendas dhe ndërkombëtarë, veprimtaria profesionale e të cilëve lidhet ngushtësisht me çështjet e viktimave të krimit.
9. Grupi ndërinstytucional i punës, gjatë ushtrimit të detyrave të përcaktuara në pikën 7, të këtij urdhri, mbështetet nga sekretariati teknik, anëtarët e të cilët të përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.
10. Kryetari i grupit ndërinstytucional të punës të informojë Kryeministrin çdo muaj për mbarëvajtjen e procesit të punës.
11. Titullarët e institucioneve të përcaktuara në pikën 3, të këtij urdhri, të caktojnë nëpunësit përgjegjës, veprimtaria profesionale e të cilëve lidhet ngushtësisht me çështjet e viktimave të krimit, nga institucionet e tyre, dhe të njoftojnë Ministrinë e Drejtësisë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e urdhrit.
12. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, grupi ndërinstytucional i punës dhe sekretariati teknik për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDIRAMA

A large, stylized handwritten signature in black ink is written over the printed name 'EDIRAMA'. The signature is fluid and cursive, starting with a large loop and ending with a long horizontal stroke.


NR.PROT. 1391/1
DATË 6.4.2023

KUVENDIT
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRIT TË SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E
JASHTME
AGJENCISË SHTETËRORE TË PROGRAMIMIT
STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS
AKADEMISË SË SIGURISË
AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT
INSTITUTIT TË STATISTIKAVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PËRMBARIMIT
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË
SHTETIT
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË
PROVËS
DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS
KOMITETIT SHQIPTAR TË BIRËSIMEVE
INSTITUTIT TË MJEKËSISË LIGJORE
QENDRËS SË PARANDALIMIT TË KRIMEVE TË TË
MITURVE DHE TË RINJVE
AGJENCISË SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE
MBROJTJEN E FËMIJËS
AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E
VETËQEVERISJES VENDORE
SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË GJENDJES
CIVILE
AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË
SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KRIMIT TË
ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT
AVOKATIT TË POPULLIT
KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI
KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

AUTORITETIT TË MEDIAS AUDIOVIZIVE
DHOMËS SË AVOKATISË SË SHQIPËRISË
DHOMËS KOMBËTARE TË NDËRMJETËSVE
URDHRIT TË PSIKOLOGUT
URDHRIT TË PUNONJËSIT SOCIAL
TË GJITHA BASHKIVE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll GACI



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjëll Gaci', is written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISË' at the top and 'KESHILLI I MINISTERIAVE' at the bottom, with a central emblem.